



PYETJE & PERGJIGJE

Jezus Krishti

A pohoi Jezusi se ishte Perëndi?

Krishterimi ndryshon nga të gjitha fetë e botës. Një arsye e rëndësishme është se themeluesi i saj, Zoti Jezus Krisht, pohoi se ishte plotësisht Perëndi. Buda nuk pohoi se ishte Perëndi. Moisiu nuk tha kurrë që ai ishte Jehova. Muhamedi nuk tha që ai ishte Allahu. Zoroasteri nuk pohoi kurrë se ishte Ahura Mazda. Megjithatë Zdrukthëtari i përlur nga Nazareti shpalli se kushdo që me të vërtetë e kishte parë Atë (Jezusin), atëherë kishte parë Atin e Tij (Gjoni 14:9). Krishti tha se Ai ekzistonte para Abrahamit: “Abrahami, ati juaj, ngazëllohej në shpresën që të shihte ditën time; e pa dhe u gëzua”. Judenjtë, pra, i thanë: “Ti ende nuk je pesëdhjetë vjeç dhe e paske parë Abrahamin?”. Jezusi u tha atyre: “Në të vërtetë, në të vërtetë unë po ju them: para se të kishte lindur Abrahami, unë jam” (Gjoni 8:56-58).

Krishti tha se Ai ishte i barabartë me Atin: “Por Jezusi iu përgjigj atyre: ‘Im Atë vepron deri më tash, e edhe unë veproj’. Për këtë judenjtë kërkonin edhe më tepër ta vrisnin, sepse jo vetëm se shkelte të shtunën, por edhe se thoshte se Perëndia ishte ati i vet, duke e barazuar veten me Perëndinë”. Gjoni 5:17-18).

Gjithashtu Jezusi shpalli: “Në fakt ashtu si Ati ringjall të vdekurit dhe u jep atyre jetën, po kështu edhe Biri i jep jetën kujtdo që do. Sepse Ati nuk gjykon asnjë, por gjithë gjyqin ia dha Birit” (Gjoni 5:21-22). Ai jo vetëm që pohoi se ishte Perëndi, por edhe e vërtetoi se ishte Perëndi duke ringjallur njerëz nga të vdekurit!

Krishti tha se Ai mund të falte mëkatet. Në Marku 2:5-7 lexojmë: “Jezusi, kur pa besimin e tyre, i tha të paralizuarit: ‘O bir, mëkatet e tua të janë falur!’. Por aty po rrinin ulur disa skribë, të cilët, në zemër të vet, po mendonin: ‘Pse vallë ky po flet blasfemi. Kush mund të falë mëkatet, veç Perëndisë vetë?’” (Marku 2:5-7). Fuqia për të falur mëkatet e kryera kundër Perëndisë është diçka që Bibla e mëson qartë se vetëm Perëndia mund ta bëjë. Profeti hebre Isaia citon Perëndinë duke thënë: “Unë, pikërisht unë, jam Ai që për hir të Vetvetes fshij shkeljet e tua dhe nuk do t’i mbaj mend mëkatet e tua” (Isaia 43:25).

Pohimet e Krishtit janë të padyshimta. Kur Ai i pyeti autoritetet fetare se përse donin ta vrisnin me gurë, ata iu përgjigjën: “Ne nuk të vrasim me gurë për asnjë vepër të mirë, po për blasfemi, dhe sepse ti, duke qenë njeri, e bën veten Perëndi” (Gjoni 10:33). Judenjtë e kuptuan se kush Ai thoshte se ishte edhe pse skeptikët modernë nuk arrijnë ta kuptojnë.

Dhiata e Re mëson se Krishti është Krijuesi i gjithësisë: “Të gjitha gjërat u bënë me anë të Tij,

dhe pa Atë nuk u bë asnjë nga ato që u bënë” (Gjoni 1:3). Ai vazhdon t’i mbajë të gjitha gjërat bashkë. “Ai është përpara çdo gjëje dhe të gjitha gjërat qëndrojnë në Të” (Kolozianëve 1:17). Pali thotë se Krishti ishte Perëndia i shfaqur në mish njerëzor (1 Timoteut 3:16). Apostulli Gjon i drejtohet Krishtit si “Fjala” dhe thotë “Fjala ishte Perëndi” (Gjoni 1:1).

Identiteti i Zotit Jezus Krisht është qendror për krishterimin. Mes Personit Jezus Krisht dhe feve të botës bashkë me themeluesit e tyre, ndodhet një “kanion i madh” që i ndan nga njëri-tjetri. Konfucianizmi është një grumbull mesimesh; vetë Konfuci nuk është qendror. Islami supozohet se është zbuluesi e Allahut, dhe Muhamedi është vetëm një profet. Budizmi thekson parimet e Budës, por jo vetë Budën. Dhe në fenë hindu nuk ka ndonjë themelues të njohur historik. Por në thelb të krishterimit është Krishti. Ai jo vetëm që mësoi të vërtetën, por pohoi se ishte e vërteta: “Jezusi i tha: ‘Unë jam udha, e vërteta dhe jeta; askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet Meje’” (Gjoni 14:6). Kush është Jezus Krishti është pyetja e rëndësishme për ty. A është Ai Biri i Perëndisë? A është Ai e vetmja rrugë për të arritur Perëndinë?

Kjo është arsyeja përse ne themi që krishterimi nuk është një fe; ai është një marrëdhënie. Ti nuk bëhesh i/e krishterë thjesht duke ditur rreth Krishtit dhe mesimeve të Tij; ti duhet ta njohësh Atë personalisht: “Dhe kjo është jeta e përjetshme, të të njohin Ty, të vetmin Perëndi të vërtetë, dhe Jezu Krishtin që Ti ke dërguar” (Gjoni 17:3). Kjo njohje vjen së pari përmes dëgjimit dhe përgjigjes “po” për atë që Ai thotë në Bibël, në Fjalën e Perëndisë. Çdo marrëdhënie e vërtetë bazohet te ndershmëria dhe ne duhet të jemi të sinqertë me Të rreth gjendjes sonë frymërore të vërtetë. Pastaj duke pranuar ofertën e tij të mahnitshme për të zënë vendin tonë – duke marrë mëkatin tonë dhe duke na dhënë qëndrimin e Tij të drejtë para Perëndisë – ne marrim jetë të re në Krishtin Jezus, Zotin tonë.